


Udhëzues informues për praktikuesit për  
**QASJEN NË TË DREJTAT PRONËSORE  
NË KOSOVË ME THEKS NË TË DREJTAT  
E GRAVE NË PRONË**



Dhjetor 2021



Udhëzues informues për praktikuesit për  
**QASJEN NË TË DREJTAT PRONËSORE  
NË KOSOVË ME THEKS NË TË DREJTAT  
E GRAVE NË PRONË**

Dhjetor 2021



# PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
HYRJE	3
KAPITULLI 1: STANDARDET NDËRKOMBËTARE, DHE STANDARDET QË ZBATOHEN NË KOSOVË PËR PROMOVIMIN E BARAZISË GJINORE NË QASJEN NË TË DREJTAT PRONËSORE	4
Korniza ligjore ndërkombëtare	4
Korniza ligjore në Kosovë	4
KAPITULLI 2: ÇKA ËSHTË PRONA DHE ÇKA JANË TË DREJTAT PRONËSORE?	6
KAPITULLI 3: LLOJET E REGJISTRIMIT TË PRONËS	7
Çka është pronësia individuale?	7
Regjistrimi i pronës - para, gjatë dhe pas martesës	7
KAPITULLI 4: CILAT JANË TË DREJTAT NË TRASHËGIMI?	8
KAPITULLI 5: VENDBANIMET JOFORMALE DHE NDËRTIMET PA LEJE	9
Vendbanimet joformale	9
Ndërtimet pa leje	10
KAPITULLI 6: CILAT JANË PALËT E INTERESIT NË KOMUNË?	10
KAPITULLI 7: SI TA REGJISTRONI PRONËN?	11
Si ta regjistroni pronën e blerë?	11
Si të regjistrohet prona e trashëguar?	11
Si ta regjistroni të drejtën pronësore me vendim të gjykatës?	13
Si të regjistrohet prona e fituar përmes dhurimit?	13
PËRFUNDIME	14
SHTOJCA 1: FORMULARI I REGJISTRIMIT TË PRONËS	15
SHTOJCA 2: REGJISTRI KOMUNAL	16

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky udhëzues është hartuar për praktikuesit që punojnë në fushën e të drejtave pronësore, si organizatat e shoqërisë civile, noterët, zyrat kadastrale dhe organet komunale, ku palët e interesuara mund t'i drejtojnë pyetjet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me të drejtat e tyre pronësore, me qëllim që të sigurojnë se të gjithë kanë qasje të barabartë në pronë dhe të në drejtat e banimit në Kosovë. Udhëzuesi ofron informacion mbi konceptet kryesore që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore; shpjegon, hap pas hapi, procesin e regjistrimit të një prone që është blerë, trashëguar ose ndarë në bazë të një vendimi gjyqësor. Në fund, paraqitet lista gjithëpërfshirëse e aktorëve kryesorë në nivel komunal të cilët sigurojnë që respektohet qasja e një individi në të drejtat pronësore duhet.

Institucionet e Kosovës kanë zhvilluar një kornizë përkatëse të politikave dhe legjisllacionit që është përcaktuar në strategjinë kombëtare të Kosovës për të drejtat pronësore, Kushtetutën, ligjin për pronën dhe të drejtat e tjera sendore, ligjin për trashëgiminë, ligjin për familjen. Siç shpjegohet në nenin 22 të Kushtetutës, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, si dhe instrumente të tjera ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt dhe sigurojnë mbrojtje gjithëpërfshirëse të të drejtave pronësore, përfshirë të drejtat e grave.

E drejta në pronë është një nga të drejtat kryesore të njeriut, prandaj dhe mbrojtja dhe promovimi i kësaj të drejte nga institucionet e Kosovës është me rëndësi thelbësore për të konfirmuar zotimin e tyre për sundim të ligjit, qeverisje të mirë dhe pajtueshmëri me mekanizmat ndërkombëtarë dhe vendorë për të drejtat e njeriut, përfshirë barazinë gjinore.

Megjithatë, gjatë aktiviteteve dhe monitorimit në terren, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) zbuloi se gratë, personat e zhvendosur dhe komunitetet jo shumicë në veçanti përballen me sfida në qasjen e lirë dhe gëzimin e të drejtave të tyre pronësore. Mangësi të ngjashme u theksuan edhe në Strategji, ku theksohet se për shkak të traditave patriarkale dhe praktikave zakonore, disa grave vazhdojnë t'u mohohen të drejtat e tyre pronësore. Si pasojë, situata aktuale pengon fuqizimin ekonomik dhe mirëqenien sociale të grave dhe komuniteteve jo-shumicë.

Në përfundim, është me rëndësi të madhe që institucionet e Kosovës dhe shoqëria civile ta rrisin angazhimin e tyre përmes dhënies së këshillave profesionale të bazuara në ligj dhe realizimit të fushatave të ndërgjegjësimit, për të siguruar që gratë dhe burrat nga të gjitha komunitetet kanë qasje të barabartë në të drejtat pronësore. Ky publikim është një hap përpara në atë drejtim. Jo vetëm që është për të mbështetur praktikuesit, por edhe për të siguruar informacion përkatës për këdo që dëshiron të mësojë për Kosovën dhe kornizën ligjore ndërkombëtare, hapa konkretë për regjistrimin e një prone dhe kë të kontaktojë në këto raste.

*Strategjia Kombëtare e Kosovës për të Drejtat Pronësore është dokumenti kryesor i politikave të Qeverisë së Kosovës për çështjet e të drejtave pronësore. Ai siguron vizion strategjik për mbrojtjen e të drejtave pronësore në Kosovë. Sipas Strategjisë, “mungesa e qartësisë në legjislacionin për të drejtat e pronës së paluajtshme, informaliteti i përhapur në sektorin e pronës dhe zbatimin jokonsistent i të drejtave ka dobësuar sigurinë e të drejtave pronësore në Kosovë. Të drejtat e pasigurta në pronë ndikojnë në të drejtat e njeriut, nuk fuqizojnë komunitetet e marginalizuara dhe pengojnë rritjen ekonomike”<sup>1</sup>. Në këtë kontekst, Strategjia njihet si sfidat me të cilat përballen gratë, personat e zhvendosur (DP) dhe anëtarët e komuniteteve jo shumicë për të ushtruar plotësisht të drejtat e tyre në pronë.<sup>2</sup>*

Përkundër përmirësimeve të shënuara në vitet e fundit në Kosovë, gratë janë pronare të vetëm rreth 17% të pronave, vetëm 15% e grave që kanë në pronësi biznese kanë marrë kredi bankare për biznes dhe vetëm 5% e grave janë fermere të licencuara.<sup>3</sup> Gratë që nuk kanë pronë dhe që nuk janë aktive në tregun e punës janë në pozitë të cenueshme. Atyre u kufizohet qasja në kredi bankare, hapja e biznesit dhe, në këtë mënyrë, bëhen ekonomikisht të varura. Varësia ekonomike i bën gratë më të cenueshme ndaj formave të ndryshme të diskriminimit, veçanërisht ndaj dhunës me bazë gjinore. Pronësia dhe posedimi i tokës/pronës është një prej mekanizmave që mund t'u garantojnë grave siguri dhe sigurinë fizike dhe ekonomike.

Prandaj, qasja në pronë dhe gëzimi i të drejtave pronësore në Kosovë vazhdon të jetë çështje shqetësuese. Përderisa në përgjithësi politikatat dhe legjislacioni ekzistues për të drejtat pronësore është në nivel mjaft të avancuar për sigurimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave, e njëjta nuk vlen edhe për zbatimin e tyre. Për më tepër, normat shoqërore ende vazhdojnë të ndikojnë në përjashtimin e grave nga të drejtat pronësore, përkundër normave ligjore që ofrojnë të drejta të tilla. Institucionet e Kosovës, përkundër disa zhvillimeve pozitive, ende mbesin prapa kur është fjala për mbrojtjen e të drejtave pronësore të komuniteteve të cenueshme, veçanërisht ato të grupeve specifike të grave.

Ky udhëzues ka për qëllim t'i informojë organizatat e shoqërisë civile dhe organet komunale që ofrojnë shërbime për të drejtat pronësore lidhur me burimet dhe shërbimet e disponueshme në nivel komunal, ku palët e interesuara mund t'i drejtojnë pyetjet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me të drejtat e tyre pronësore. Një shoqëri civile e informuar mirë, e që është në dijeni të shërbimeve dhe organeve komunale përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fuqi, është qëllimi përfundimtar në ngritjen e vetëdijes për qasje të barabartë në pronë dhe të drejta të banimit në Kosovë. Për më tepër, udhëzuesi shpjegon konceptet kryesore që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe qasjen hap-pas-hapi për regjistrimin e pronës së blerë, trashëguar ose ndarë në bazë të një vendimi gjyqësor.

Informatat mbi çështjet e të drejtave pronësore që prekin PZH-të, komunitetet joshumicë dhe gratë janë mbledhur përmes aktiviteteve të rregullta të monitorimit nga OSBE-ja që nga viti 1999, veçanërisht gjatë sesioneve të informacionit të organizuar për gratë në zonat rurale mbi të drejtat e tyre pronësore në vitin 2019.

Udhëzuesi është i strukturuar në shtatë kapituj. Pas hyrjes, kapitulli 1 përshkruan standardet përkatëse ndërkombëtare, dhe politikatat dhe legjislacionin e aplikuar në Kosovë për të promovuar qasje të barabartë në të drejtat pronësore. Kapitulli 2 përshkruan kuptimin e pronës dhe të drejtave pronësore. Kapitulli 3 shtjellon llojet e regjistrimit të pronës. Kapitulli 4 i referohet të drejtave të trashëgimisë. Kapitulli 5 flet për vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje. Ndërsa Kapitulli 6 paraqet akterët kryesorë në komunë. Kapitulli 7 informon mbi regjistrimin e pronës. Në përfundim, udhëzuesi ofron një

<sup>1</sup> Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare e Kosovës për të Drejtat Pronësore, 2016, e disponueshme në: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/National\\_Strategy\\_and\\_Annexes\\_ENG.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Strategy_and_Annexes_ENG.pdf), f. 7 (qasur më 7 korrik 2021).

<sup>2</sup> Strategjia ka vendosur pesë objektiva kryesore për të adresuar sfidat në realizimin e të drejtave pronësore: 1: Sigurimi i të drejtave të pronës duke forcuar kuadrin ligjor; Sigurimi i të drejtave mbi pronën duke adresuar informalitetin në sektorin e pronave të paluajtshme; 3: Garantimi dhe zbatimi i të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe komuniteteve joshumicë; 4: Garantimi dhe zbatimi i të drejtave pronësore të grave; 5: Promovimi i përdorimit produktiv të pronës së paluajtshme për të nxitur rritjen ekonomike.

<sup>3</sup> Qendra për Studime Gjinore, *Indeksi Pilot i të drejtave pronësore të grave*, në dispozicion në: [http://kgscenter.net/site/assets/files/1741/eng\\_index.pdf](http://kgscenter.net/site/assets/files/1741/eng_index.pdf), 2019, f. 8. (qasur më 7 korrik 2021).

numër sugjerimesh dhe këshillash se si të përmirësohen të drejtat pronësore në Kosovë, me theks në të drejtat e grave. Së fundi, udhëzuesi përfundon me një bazë të gjerë të dhënash komunale me kontakte të institucioneve dhe organizatave kryesore që punojnë në të drejtat e pronësisë në secilën komunë.

## KAPITULLI 1: STANDARDET NDËRKOMBËTARE, DHE STANDARDET QË ZBATOHEN NË KOSOVË PËR PROMOVIMIN E BARAZISË GJINORE NË QASJEN NË TË DREJTAT PRONËSORE

### KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE

*Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut* thekson se të gjithë gëzojnë të drejtën të kenë pasuri, si vetëm ashtu edhe bashkë me të tjerët dhe se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga pasuria e tij.<sup>4</sup>

*Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Protokolli 1)* përcakton se çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parapara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.<sup>5</sup>

*Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave* (CEDAW) kërkon që bashkëshortët të kenë të njëjtat të drejta në lidhje me pronësinë, blerjen, menaxhimin, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë. Dokumenti është i zbatueshëm drejtpërsëdrejti në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës.<sup>6</sup>

*Deklarata e Pekinit dhe Platforma e Veprimit* siguron qasje të barabartë të grave në burimet ekonomike, përfshirë tokën, kredinë, shkencën dhe teknologjinë, trajnimin profesional, informacionin, komunikimin dhe tregjet, si një mjet për të çuar më tej përparimin dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, përfshirë përmes rritjes së kapaciteteve të tyre për të gëzuar përfitimet e qasjes së barabartë në këto burime, mes të tjerash edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.<sup>7</sup>

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Imigrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre gjithashtu garantojnë të drejta të ndryshme në lidhje me qasjen, përdorimin dhe kontrollin e tokës dhe burimet e tjera prodhuese.<sup>8</sup>

### KORNIZA LIGJORE NË KOSOVË<sup>9</sup>

*Kushtetuta* përcakton që të gjithë kanë të drejtë të kenë pronë dhe se askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona (neni 46).

*Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore* rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen dhe shuarjen e të drejtave sendore dhe përcakton se 'çdo person mund të fitojë të drejta sendore, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj'. Ai gjithashtu përcakton pasurinë e luajtshme, pasurinë e paluajtshme, pronësinë, bashkëpronësinë, dhe pronësinë e përbashkët, etj.

<sup>4</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*, qasur më 17 nëntor 2020.

<sup>5</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Protokolli 1)*, qasur më 17 nëntor 2020.

<sup>6</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*, qasur më 17 nëntor 2020.

<sup>7</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Deklarata e Pekinit dhe Platforma e Veprimit*, qasur më 17 nëntor 2020.

<sup>8</sup> Të gjitha dokumentet e lartcekura në atë paragraf mund të gjenden në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), <https://www.ohchr.org/>, qasur më 17 nëntor 2020.

<sup>9</sup> Të gjithë ligjet dhe udhëzimet administrative që cekën më poshtë mund të gjenden në faqen e internetit të Gazetës Zyrtare të Kosovës, [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=blogsection&id=4&Itemid=28](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=blogsection&id=4&Itemid=28), qasur më 17 nëntor 2020



*Strategjia Kombëtare e Kosovës për të Drejtat Pronësore* është dokumenti kryesor politik që synon të sigurojë qartësi në legjislacionin për të drejtat e pronës së paluajtshme, të trajtojë informalitetin e përhapur në sektorin e pronës dhe zbatimin jokonsistent të të drejtave që kanë dobësuar sigurinë e të drejtave pronësore në Kosovë. Zbatimi i suksesshëm i Strategjisë pritet të ofrojë siguri për të drejtat pronësore, duke pasur ndikim pozitiv në të drejtat e njeriut, dhe do të fuqizonte komunitetet e marginalizuara dhe do të stimulonte rritjen ekonomike.

*Ligji nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor* siguron qeverisje të qëndrueshme, përdorim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim të balancuar ekonomik, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, sigurim të trajtimit të barabartë, sigurim të lëvizjes së lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët (Neni 1, paragrafi 2)

Një nga qëllimet e *ligjit nr. 06/L-024 për Trajtimin e ndërtimeve pa leje* është krijimi i procedurave të thjeshtuara për të mundësuar legalizimin dhe për t'i ndihmuar qytetarët që t'i kuptojnë përfitimet nga ndërtimet e tyre (neni 1, para. 1, nënparagrafi 1.2)

Qëllimet e *ligjit nr. 03/L-164 për programet specifike të financimit të* banimit janë krijimi i banimit të qëndrueshëm për familjet ose individët që janë në situatë të dobët ekonomike dhe nuk mund të përballojnë të marrin me qira ose të blejnë banim. **Ligji i jep përparësi përzgjedhjes së përfituesve që janë gra kryefamiljare; burrë ose grua të shkurorëzuar e që kujdeset për fëmijët, dhe fëmijët me statusin e jetimit** (neni 11, para. 1, nën-paragrafët 1.1.3; 1.1.4 dhe 1.1.5).

*Ligji nr. 2004/26 për trashëgiminë* përcakton se **të gjithë personat në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi**. Ligji përcakton se 'fëmijët e lindur jashtë martesë, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent si dhe fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim'. Kur nuk ka testament apo nëse testamenti është i pavlefshëm, fëmijët dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit trashëgojnë të parët, në pjesë të barabarta. Trashëgimtarët mund të heqin dorë nga trashëgimia e tyre para një gjykate ose një noteri, nëse nuk e bëjnë me detyrim. Një çift jashtëmartesor (një grua dhe një burrë) mund të trashëgojnë njëri-tjetrin si bashkëshortë, nëse marrëdhënia ka zgjatur të paktën 10 vjet ose të paktën 5 vjet dhe kanë fëmijë.

*Ligji nr. 2004/32 për Familjen* përmban një kapitull mbi marrëdhëniet pronësore të bashkëshortëve. **Prona që i përket një bashkëshorti në kohën e lidhjes së martesës mbetet në pronësi të veçantë. Prona e fituar me punë gjatë martesës është në pronësi të përbashkët**. Edhe nëse prona e përbashkët martesore është regjistruar nën emrin e një bashkëshorti, prona konsiderohet në pronësi të përbashkët dhe sikur të ishte regjistruar në emër të të dy bashkëshortëve. Pëlqimi i të dy bashkëshortëve kërkohet në rast të tjetërsimit të pronës. Në nenin 47, ligji parashikon që prona e fituar gjatë martesës i takon bashkëshortëve në mënyrë të barabartë, përveç nëse ata kanë rënë dakord ndryshe (për shembull, në një marrëveshje paramartesore). Kur gjykata vlerëson pjesën e secilit bashkëshort në pronën e përbashkët, vendimi bazohet në kontributin e secilit bashkëshort, duke marrë parasysh jo vetëm të ardhurat personale, por edhe ndihmën që njëri bashkëshort i dha bashkëshortit tjetër, duke përfshirë "kujdesin e fëmijëve, kryerjen e punëve të shtëpisë, kujdesin dhe mirëmbajtjen e pronës dhe çdo forme tjetër të punës dhe bashkëpunimit që kanë të bëjnë me administrimin, mirëmbajtjen dhe rritjen e pronës së përbashkët" (neni 54).

*Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 03/2016 për Masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve* është një shembull i miratimit së një legjislacioni të ndjeshëm gjinor për të nxitur **regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve** në regjistrin publik. Qëllimi i tij është që të rrisë numrin e grave që janë të regjistruara si pronarë të përbashkët dhe të përshpejtojë realizimin e barazisë midis grave dhe burrave në aspektin e të drejtave pronësore (diskriminimi pozitiv). Ky akt normativ është i detyrueshëm për të gjitha institucionet në të gjitha nivelet, autoritetet e tjera dhe personat fizikë që ushtrojnë autorizime publike në lidhje me regjistrimin e pasurive të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve.

Në vitin 2016, është vërejtur që vetëm 105 raste janë regjistruar nga çiftet. Ky numër u rrit në 4,000 deri në fund të vitit 2018.<sup>10</sup>

*Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (2015)* siguron kornizën ligjore për të siguruar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë për të marrë pjesë në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fushat e tjera të jetës shoqërore në Kosovë. Ligji mëton që gjithashtu të krijojë kushte dhe mundësi për barazi gjinore përmes politikave që mbështesin zhvillimin e përgjithshëm, veçanërisht për përmirësimin e statusit të grave, në mënyrë që ato të kenë qasje të barabartë në mundësi.

*Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024 (Programi)*<sup>11</sup> siguron kornizën e politikave për të institucionalizuar qasjen dhe pjesëmarrjen e burrave dhe grave në të gjitha aspektet e jetës. Sidoqoftë, programi gjithashtu e pranon që gratë aktualisht nuk i gëzojnë të drejtat e tyre siç bëjnë burrat dhe se duhet të trajtohen tre fusha specifike për të punuar drejt barazisë gjinore në Kosovë, përkatësisht fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale, zhvillimi njerëzor, rolet dhe raportet gjinore dhe të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguri.

*Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2015)* është pjesë e kornizës ligjore për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit bazuar, *ndër të tjera*, në seks, gjini, identitet gjinor, orientim seksual, për të zbatuar parimin e trajtimit të barabartë, po ashtu në lidhje me strehimin dhe format e tjera të pronës (neni 2, §1.9.). Zbatimi i tij është përgjegjësi e Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

## KAPITULLI 2: ÇKA ËSHTË PRONA DHE ÇKA JANË TË DREJTAT PRONËSORE?

Prona përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, mallra fizikë ose pasuri, por përfshinë edhe një sërë interesash ekonomike të luajtshëm dhe të paluajtshëm. Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në Kosovë<sup>12</sup> rregullon llojet e pronave që përfshijnë:

- **Pronën e luajtshme**, si automjetet ose pasurinë që nuk është e lidhur fizikisht me tokën.
- **Pronën e paluajtshme**, si shtëpitë ose banesat, vetë tokën ose pronë të tjera që janë të lidhura fizikisht me tokën.

E drejta e pronës është e drejtë themelore e njeriut, e njohur me një numër mekanizmash ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut (shih faqe 5) Sidoqoftë, e drejta e pronës është e drejtë e kualifikuar që do të thotë se ajo i nënshtrohet disa kushteve ose kufizimeve. Korniza ligjore në Kosovë garanton të drejtën për të pasur pronë dhe përcakton se ligji në përputhje me interesin publik rregullon përdorimin e pronës. Për më tepër, **askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga pronë**, por qeveria mund të shpronësojë pronën nëse shpronësimi është i autorizuar me ligj; i nevojshëm për të arritur një qëllim publik ose për të promovuar interesin publik; dhe ata, pronë e të cilëve është shpronësuar, marrin kompensim të menjëhershëm dhe të duhur.

Prandaj, pronësia është shumë e rëndësishme për gëzimin e të drejtave pronësore. Pronësia i referohet një grupi të drejtash që i ka titullari i të drejtave pronësore, që përfshin: **Të drejtën e posedimit të pronës, të drejtën e tjetërsimit të pronës, të drejtën për t'u mos u penguar nga gëzimi i këtyre të drejtave**. Në Kosovë, zotërimi i pronës është proces në dy hapa. Krahas titullit pronësor, regjistrimi i pronës në regjistrat kadastralë është kërkesë ligjore. Prandaj, procesi i **regjistrimit të pronës** garanton të drejtat e pronësisë<sup>13</sup>. Prandaj, njohja e mënyrës së regjistrimit të pronës është thelbësore për avancimin e të drejtave pronësore të grave.

<sup>10</sup> UNICEF në Kosovë, Analizë e situatës së grave dhe fëmijëve në Kosovë, 2019, <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1141/file/SITAN.pdf>, p. 21-22. (7 korrik 2021).

<sup>11</sup> Agjencia për Barazi Gjinore, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, <https://abgj.rks-gov.net/al/publikimet/107/programi-kosoves-per-barazi-gjinore>, qasur më 4 dhjetor 2020.

<sup>12</sup> Ligji nr. 2009/03-L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore në Kosovë, 15 korrik 2009.

<sup>13</sup> Ligji nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, siç është ndryshuar me anë të Ligjit nr. 04/L-009, 11 gusht 2011.

Ndryshe, disa pronarë, përfshirë gra, janë privuar nga të drejtat e tyre pronësore përmes uzurpimit të paligjshëm, si pasojë e konfliktit në Kosovë. Në atë rast, Agjencia e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronave (ish Agjencia Kosovare e Pronës), ka qenë institucioni kryesor për t'i mbështetur individët në rikthimin e qasjes së tyre në pronë.

## KAPITULLI 3: LLOJET E REGJISTRIMIT TË PRONËS

### ÇKA ËSHTË PRONËSIA INDIVIDUALE?

Në Kosovë, **pronësia individuale e pronës** ka të bëjë me të drejtën individuale mbi pronën, posedimin e saj, përjashtimin e të tjerëve nga çdo ndërhyrje në atë pronë dhe vendosjen në mënyrë të pavarur për ta shitur ose dhënë me qira pronën. Me fjalë të tjera, të drejtat pronësore nuk ndahen me ndonjë person tjetër. Gratë dhe burrat mund ta regjistrojnë pronën si pronarë të vetëm kur ata individualisht e blejnë pronën; kur ata e trashëgojnë pronën dhe kur pronësia iu është bartur vetëm atyre.<sup>14</sup> Prona që fitohet gjatë martesës nuk përbën pronësi individuale mbi pronën dhe në rast të shkurorëzimit i nënshtrohet ndarjes së barabartë.

Në Kosovë, **prona e paluajtshme dhe automjetet duhet të regjistrohet në regjistrat kadastrale**.<sup>15</sup> Prona e paluajtshme regjistrohet me anë të një kërkesë me shkrim në zyrën kadastrale të komunës ku ndodhet prona. Zyra kadastrale komunale pastaj konfirmon kohën dhe datën e pranimit të kërkesës për regjistrim. Kërkesa për regjistrimin e shtëpisë ose banesës duhet të paraqitet nga pronari ose një person ligjërsh i autorizuar për ta regjistruar pronën në emër të pronarit.<sup>16</sup>

### REGJISTRIMI I PRONËS - PARA, GJATË DHE PAS MARTESËS

Ka mënyra të ndryshme për të regjistruar pronën bashkërisht, varësisht nga fakti nëse prona është në bashkëpronësi me një individ tjetër ose është në pronësi të përbashkët me bashkëshortin/en. Kjo pjesë diskuton konceptin e pasurisë së përbashkët ose të bashkëpronësisë, si dhe çështjet në lidhje me regjistrimin e pronës gjatë martesës, si dhe ndarjen e pasurisë pas shkurorëzimit.

**Bashkëpronësia** ka të bëjë me ndarjen e pronësisë mbi pronën me një individ ose individë të tjerë. Nëse hiset e pronësisë nuk deklarohen paraprakisht, supozohet se të gjithë pronarët kanë pjesë të barabarta.

Bashkëpronarëve u lejohej të përdorin pronën në përpjesëtim me pjesën e tyre, ndërsa çdo pasuri e përfituar nga prona ndahet në proporcion me hiset e tyre. Bashkëpronari po ashtu ka të drejtë ta tjetërsojë pjesën e vet të pasurisë pa pëlqimin e pronarëve të tjerë. Sidoqoftë, të gjithë pronarët duhet të administrojnë bashkërisht pronën e përbashkët.<sup>17</sup>

Bashkëpronësia është e ndryshme nga **pasuria e përbashkët martesore**, e cila i referohet të drejtave të barabarta pronësore të të dy bashkëshortëve në pjesën më të madhe të pasurisë së krijuar gjatë martesës, duke përfshirë pronat. Prandaj, çdo pasuri e fituar gjatë martesës konsiderohet pasuri e përbashkët e të dy palëve dhe, ligjërsh, **regjistrimi i pasurisë bëhet në emrat e të dy bashkëshortëve**. Të dy bashkëshortët kanë pjesë të barabarta në pasurinë e grumbulluar gjatë martesës. Sidoqoftë, në Kosovë, pasuria e përbashkët martesore shpesh nuk regjistrohet në emrat e të dy bashkëshortëve. Meqenëse të dy bashkëshortët kanë pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët martesore, regjistrimi duhet ta pasqyrojë këtë. **Pronësia mbi pronën mund të ndihmojë individët të kenë kolateral që do tu mundësonte të kontraktojnë kredi hipotekaare dhe kredi të tjera, të fillojnë biznes dhe të kenë kolateral.** Prandaj, është qenësore që të

<sup>14</sup> Shih nenin 18 të Ligjit nr. 2009/03-L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore në Kosovë, 15 korrik 2009.

<sup>15</sup> Informatat për mënyrën e regjistrimit të pronës mund të gjenden në faqen e internetit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës: <http://www.kca-ks.org/sr/regjistro-pronen> [në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe].

<sup>16</sup> Shih nenin 13, Ligji Nr. 04/L-013 për Kadastër, 29 korrik 2011.

<sup>17</sup> Ligji nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, neni 51-53.

dy bashkëshortët të kenë qasje të barabartë në mundësitë që lindin nga të qenit pronarë të pasurive, të cilat mund të jenë shumë më të vështira nëse prona regjistrohet në emër të vetëm njërit bashkëshort. Në këtë rast, nëse njëri partner dëshiron të jetë aktiv në sferën ekonomike (të marrë kredi, qasje në subvencione, të fillojë biznes), kjo është e pamundur për faktin se ai/ajo nuk ka pronësi mbi pronën.

Jo e gjithë pasuria martesore konsiderohet pasuri e përbashkët martesore. **Prona e veçantë martesore** është pasuri që i përket ekskluzivisht njërit prej bashkëshortëve. Kjo përfshin:

- Pasurinë e fituar para martesës.
- Pasurinë e trashëguar apo pasurinë e dhuruar.
- Pjesën e pasurisë së përbashkët që i përket secilit bashkëshort.
- Veprat e artit dhe pronën intelektuale.

Në rast të **shkurorëzimit** dhe zgjidhjes së martesës, të dy bashkëshortët gëzojnë **pjesë të barabarta** të pasurisë së tyre të përbashkët martesore. Duke pasur parasysh që pasuria e fituar gjatë martesës konsiderohet pronë e përbashkët martesore (përveç atyre pasurive të përcaktuara si pronë e veçantë martesore) pavarësisht nëse është regjistruar ose jo në emrat e të dy bashkëshortëve, pasuria duhet të ndahet në mënyrë të barabartë.

Sidoqoftë, për të siguruar që kjo zbatohet ashtu siç parashihet me Ligjin për Familjen<sup>18</sup>, **bashkëshortët gjithmonë duhet të sigurohen që pasuria e përbashkët martesore të regjistrohet në emër të të dy bashkëshortëve.**

## KAPITULLI 4: CILAT JANË TË DREJTAT NË TRASHËGIMI? <sup>19</sup>

Trashëgimia i referohet transferimit të pronës nga një person i vdekur (trashëgimtari) tek trashëguesit e tyre (pasardhësit e gjallë). Kur i vdekuri nuk ka lënë testament për ndonjërin ose tërë pronën, ose kur testamenti është plotësisht ose pjesërisht i pavlefshëm, trashëgimia bazohet në trashëgiminë (suksesionin) ligjore. Suksesioni ligjor vihet në pikëpyetje vetëm në mungesë të testamentit. Janë tri shkallë të trashëgimisë/suksesionit ligjor:

- Shkalla e parë: trashëgimia u transferohet fëmijëve dhe bashkëshortëve të të ndjerit. Fëmijët dhe bashkëshorti trashëgojnë pjesë të barabarta.
- Shkalla e dytë: trashëgimia i transferohet bashkëshortit dhe prindërve të të ndjerit (kur nuk ka fëmijë). Bashkëshorti dhe prindërit trashëgojnë pjesë të barabarta.
- Shkalla e tretë: trashëgimia i transferohet vetëm bashkëshortit të të ndjerit (kur nuk ka prindër dhe vëllezër e motra të të ndjerit). Bashkëshorti trashëgon pronat e plota.

*Ndërsa burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta në trashëgimi sipas kornizës ligjore në Kosovë, traditat patriarkale dhe praktikatat zakonore shpesh kanë ndikim negativ tek gratë, duke bërë që ato të mos i gëzojnë të drejtat e barabarta trashëgimore. Për shkak të presionit familjar dhe shoqëror, disa gra vendosin të heqin dorë nga e drejta e tyre për trashëgimi. Në raste të tjera, familjet vendosin të mos përfshijnë gratë trashëguese në aktin e vdekjes.<sup>20</sup> Të gjithë praktikuesit, veçanërisht noterët, duhet të kuptojnë se shkallët e identifikuar më sipër zbatohen në mënyrë të barabartë si për burrat ashtu edhe për gratë.*

<sup>18</sup> Shënimi sipër 2.

<sup>19</sup> Bazuar në ligjin nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, 28 korrik 2004.

<sup>20</sup> Agjencia për Barazi Gjinore, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>. (qasur më 24 qershor 2021).

*Fëmijët, bashkëshortët dhe prindërit janë trashëgues të detyrueshëm.<sup>21</sup> Bazat për përjashtimin nga trashëgimia janë të kufizuara dhe janë të përshkruara në Ligjin për Trashëgiminë në Kosovë. Procedurat për shqyrtimin e rasteve të trashëgimisë mund të kryhen përmes gjykatave themelore dhe noterëve brenda secilës komunë.<sup>22</sup>*

## KAPITULLI 5: VENDBANIMET JOFORMALE DHE NDËRTIMET PA LEJE

### VENDBANIMET JOFORMALE

Në Kosovë, vendbanimet joformale janë njësitë e banimit me një apo më shumë karakteristika të mëposhtme:

- Pronësia joformale e pronës.
- Shërbime elementare të pamjaftueshme ose të munguara - si uji i pijes dhe pastrimit, energjia elektrike ose sistemet e kanalizimit.
- Pjesëmarrje joadekuate në qeverisje, si dhe në procesin e vendimmarrjes, e palëve të interesuara (për shembull, gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor komunal).
- Rrezikshmëri e lartë i rrënimin strukturor të ndërtesës.

Disa nga vendbanimet joformale mund të jenë edhe më shumë kërcënuese për gratë dhe vajzat, p.sh. mungesa e nyjave sanitare, higjienës dhe qasjes në ujë të sigurt mund të kenë ndikim në të drejtat seksuale dhe riprodhuese të grave dhe vajzave.

Në Kosovë, institucionet e të gjitha niveleve janë ligjërisht të obliguara të rregullojnë vendbanimet joformale, të cilat identifikohen në dokumentet e tyre të planifikimit hapësinor komunal. Kjo mund të bëhet në njërin nga këto tri mënyra:

- Përmirësimi i gjendjes së vendbanimeve - përfshirë infrastrukturën dhe shërbimet brenda vendbanimit.
- Rrënimi dhe rindërtimi i vendbanimit, bashkë me infrastrukturën e duhur dhe ofrimin e shërbimeve. Kjo përfshin edhe zhvendosjen e banorëve për një kohë të caktuar.
- Rrënimi dhe rilokimi i tërë vendbanimit dhe banorëve në zona të reja. Ky veprim propozohet kur vendbanimi është shumë afër ndonjë zone potencialisht të rrezikshme - për shembull, kur vendbanimi është shumë afër ndonjë deponie mbeturinash urbane, ose tokës së ndotur.

Një komponent i rëndësishëm i rregullimit të vendbanimeve joformale është prioritizimi i shërbimeve të ofruara në mënyrë që zgjidhja të bëhet në një gjendje të përshtatshme. Burrat dhe gratë mund të kenë pikëpamje të ndryshme se cilat shërbime duhet të kenë përparësi, dhe cilat janë nevojat dhe shqetësimet për banorët në vendbanim. Një nga shqetësimet kryesore për gratë dhe vajzat është qasja në shëndet të sigurt riprodhues, siguria fizike, qasja në objektet e kujdesit shëndetësor, për fëmijët dhe të moshuarit, etj. Ashtu si në rastin e banimit social, komunitat kanë një detyrim ligjor të mbajnë konsultime publike me të gjithë banorët për të përcaktuar prioritetet komunale në këtë drejtim. Kontakti me grupet e nën-përfaqësuar është i një rëndësie thelbësore, përndryshe zërat dhe nevojat e tyre nuk do të jenë pjesë e planifikimit dhe rrjedhimisht do të ndodhë përjashtimi i tyre automatik.

<sup>21</sup> Përveç kësaj, sipas nenit 30 të ligjit për trashëgiminë (2004) trashëguesit e detyrueshëm janë: (1) trashëguesit e trashëgimlënësit, personat e adoptuar, pasardhësit, prindërit, dhe bashkëshorti; (2) Gjyshërit e të vdekurit dhe vëllezërit e motrat janë trashëgimtarë të detyrueshëm etëm nëse vuajnë nga një aftësi e kufizuar e përhershme dhe e plotë dhe paaftësi për punë dhe mungesë e mjeteve për jetesë.

<sup>22</sup> Informatat mbi regjistrimin e pronës së trashëguar mund të gjenden në faqen e Agjencisë Kadastrale të Kosovës: <http://www.kca-ks.org/sr/regjistro-pronen>. [në dispozicion vetëm në shqip].

Trajtimi i ndërtimeve pa leje është çështje tjetër, që mund të ndikojë në të drejtat e grave dhe burrave. Gjegjësisht, ndërtimi i ndërtesave pa leje është i përhapur në të gjithë Kosovën, duke arritur në rreth 350,000 ndërtime të tilla.<sup>23</sup> Autoritetet përkatëse e kanë adresuar çështjen përmes shpalljes së Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.<sup>24</sup> Përderisa komunitetet e kanë përgjegjësinë për të zbatuar ligjin, ato duhet të sigurojnë që të drejtat e grave të respektohen gjatë procesit, që krijon gjithashtu mundësi për të avokuar për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve.

## KAPITULLI 6: CILAT JANË PALËT E INTERESIT NË KOMUNË?

### *Nësitë komunale për të drejtat e njeriut (NJKDNJ) dhe zyrtarët komunalë për barazi gjinore (ZKBGJ)*

NJKDNJ-të dhe ZKBGJ-të janë mekanizma përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal dhe në përputhje me ligjet, politikat dhe standardet ndërkombëtare [shih f. 9 në lidhje me ZKBGJ].

### *Zyrtarët Komunalë të Kadastrit (ZKK)*

ZKK-të merren me regjistrimin e pronës private të paluajtshme dhe pronës komunale të paluajtshme. Ata gjithashtu shqyrtojnë dhe kryejnë procedurat administrative për kthimin e pronës te pronarit, dhe identifikojnë dhe japin zgjidhje me masa të përkohshme para vendimeve të gjykatave mbi pronën. ZKK-të janë gjithashtu përgjegjës për regjistrimin e hipotekave, masat e përkohshme të nxjerra nga gjykata për pronat e kontestuara, dhe për mirëmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e regjistrave të vendbanimeve, fshatrave, rrugëve dhe numrave të objekteve dhe ndërtesave

### *Organizatat Joqeveritare (OJQ)*

OJQ-të dhe OJQ-të e specializuara për të drejtat e grave mund të luajnë një rol të rëndësishëm në avokimin dhe lobimin për të drejtat e grave. OJQ-të e përfshira në listën e burimeve në këtë dokument punojnë veçanërisht për të nxjerrë barazinë gjinore dhe qasjen e barabartë në të drejtat pronësore dhe banesore. Kjo listë nuk është shteruese, por bazohet në hulumtimet në terren të OSBE-së.

### *Ndihma juridike falas*

Zyrtar rajonale të ndihmës juridike ofrojnë ndihmë juridike falas për ata që gëzojnë këtë të drejtë. Ato mund të lehtësojnë qasjen e grave në të drejtat pronësore, duke siguruar informacion ligjor dhe paraligjor, si dhe këshilla për gratë që nuk janë në dijeni për të drejtat e tyre në këtë aspekt, dhe duke i përfaqësuar gratë në gjykata ose organe administrative si dhe duke ndihmuar në përpilimin e dokumenteve ligjore dhe procedurat ligjore.

### *Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)*

IAP është një institucion i pavarur i mandatuar për të adresuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet publike në Kosovë. IAP kryen hetime, publikon raporte dhe ofron shërbime juridike dhe avokim publik. IAP ofron shërbime falas dhe pranon ankesa nga kushdo në Kosovë. Zyrat e IAP ndodhen në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Graçanicë, Gjilan dhe Ferizaj.

### *Noteria*

Shërbimi noterial është një shërbim publik që synon të mbrojë interesat ligjorë të personave fizikë dhe juridikë. Noterët janë juristë profesionist, zyrtarë publik, të emëruar nga Ministria e Drejtësisë, të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin

<sup>23</sup> USAID, Ndërtimet pa leje në Kosovë drejt legalizimit, [https://www.usaid.gov/results-data/success-stories/laying-foundations-ownership-rights-and-vibrant-property-market-through?fbclid=IwAR1LUoFXOlzim1kYMXZxid8jUTHMBXUSwtIFSeEI-D\\_oc\\_FQ3RmatUSa9M](https://www.usaid.gov/results-data/success-stories/laying-foundations-ownership-rights-and-vibrant-property-market-through?fbclid=IwAR1LUoFXOlzim1kYMXZxid8jUTHMBXUSwtIFSeEI-D_oc_FQ3RmatUSa9M), qasur më 7 korrik 2021.

<sup>24</sup> Ligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, gusht 2018.




e shërbimeve të noterisë. Funkcionet e noterisë janë: përpilimi dhe verifikimi i kontratave, noterizimi i deklaratave, vërtetimi i nënshkrimeve dhe shqyrtimi e rasteve jokontestimore të trashëgimisë dhe detyrave të tjera të parapara në Ligjin për Noterinë, nga i cili buron mandati dhe funksionet e noterëve.<sup>25</sup>

## KAPITULLI 7: SI TA REGJISTRONI PRONËN?<sup>26</sup>

### SI TA REGJISTRONI PRONËN E BLERË?

Regjistrimi i titullit pronësor në regjistrin e të drejtave pronësore të paluajtshme, në Zyrën Kadastrale Komunale, është parakusht për të fituar të drejtën e pronës mbi pronën e paluajtshme (pasi të keni lidhur një kontratë të shitblerjes, të keni marrë një vendim nga gjykata ose organet administrative, ose dokument tjetër përkatës të paraparë në Ligjin nr. 2002/5, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04 / L-009 neni 3, paragrafi 3.7).



DOKUMENTET E KËRQUARA NË ZYRËN E NOTERISË:	DOKUMENTET E KËRQUARA NË ZYRËN KADASTRALE KOMUNALE:
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kopja e letërnjoftimit tuaj të Kosovës dhe e shitësit dhe bashkëshortit tuaj.</li> <li>✓ Vërtetimi i pagesës së çmimit të blerjes (faturë bankare ose faturë personale).</li> <li>✓ Certifikata e pronësisë së shitësit, e cila lëshohet nga Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) me një pagesë prej 4 €.</li> <li>✓ Në rast se prona duhet të ndahet, një kopje e planit të pronës, lëshuar nga sektori i gjeodezisë në ZKK për një tarifë prej 5 €</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Formulari i plotësuar i aplikimit për regjistrim.</li> <li>✓ Një kopje të kontratës së shitjes, e noterizuar.</li> <li>✓ Të gjitha dokumentet e ofruara te noteri.</li> <li>✓ Vërtetimi i pagesës së taksës mbi pronën e paluajtshme (nga Zyra Komunale e Financave).</li> <li>✓ Vërtetimi i pagesës së tarifës së regjistrimit (pagesa varet nga vlera e pronës, nga 30 € në 500 €). <u>Nëse prona është regjistruar si pronë martesore (e përbashkët) midis burrit dhe gruas, nuk ka tarifë regjistrimi.</u> Çdo pagesë e tarifës ose taksës mbi 10 € duhet të bëhet në bankë dhe kërkohet dëshmi e pagesës bankare. Pagesat nën 10 € paguhen në zyrën përkatëse.</li> </ul>


### SI TË REGJISTROHET PRONA E TRASHËGUAR?

Kur personi madhor vdes, pasuria e të ndjerit duhet t'ju shpërndahet trashëgimtarëve të atij personi përmes procedurës formale të trashëgimisë. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët (djemtë dhe vajzat) kanë të drejtë të trashëgojnë pasurinë si

<sup>25</sup> Ligji nr. 06/L –010 për Noterinë, 26 dhjetor 2018.

<sup>26</sup> Shih Agjencinë Kadastrale të Kosovës, në <http://www.kca-ks.org/en/akk>, qasur më 7 korrik 2021.

trashëgimtarë të rendit të parë. Në mungesë të tyre, Ligji për Trashëgiminë rregullon rendet e trashëgimisë. Nëse të gjithë trashëgimtarët bien dakord se si ta ndajnë pasurinë ndërmjet tyre, atëherë procedura e trashëgimisë është procedurë jokontestimore që mund të fillohet në gjykatë ose te noteri. Nëse trashëgimtarët nuk bien dakord për ndarjen e pasurisë, atëherë ata duhet të shkojnë në gjykatë për ta filluar procedurën kontestimore të trashëgimisë. Trashëgimtarët duhet të pyesin gjykatën ose noterin për tarifat që duhet të paguhen në lidhje me këtë procedurë.



**Mbani mend:** Dëshmia e vdekjes duhet të përmbajë informata të plota për të gjitha pronat e luajtshme dhe të paluajtshme të të ndjerit dhe listën e të gjithë trashëgimtarëve (burra dhe gra).

DOKUMENTET E KËRKUARA NË ZYRËN KADASTRALE KOMUNALE:	NË RAST SE TRASHËGIMTARËT DUAN TË NDAJNË PRONËN:
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Formulari i kompletuar i aplikimit për regjistrim.</li> <li>✓ Vendimi i trashëgimisë i lëshuar nga një noter ose gjykatë.</li> <li>✓ Të gjitha dokumentet e dhëna noterit ose gjykatës (përveç dëshmisë së vdekjes dhe certifikatës së vdekjes).</li> <li>✓ Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë të paluajtshme (nga Zyra Komunale e Financave).</li> <li>✓ Vërtetimi i pagesës së tarifës së regjistrimit (nëse trashëgimtarët kanë vendim noterial, tarifa është 10 € për trashëgimtar. Nëse trashëgimtarët kanë vendim gjykatë, tarifa është 50 €).</li> <li>✓ Çdo pagesë e tarifës ose taksës mbi 10 € duhet të bëhet në bankë dhe kërkohet dëshmi e pagesës bankare. Të gjitha pagesat nën 10 € paguhen në zyrën përkatëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Nëse trashëgimtarët duan ta ndajnë pronën, kërkohet një studim gjeodezik i pronës.</li> <li>✓ ZKK -ja mund ta sigurojë listën e vlerësuesve dhe kompanive të vlerësimit, si dhe tarifat e vlerësimit. Trashëgimtarët duhet ta nënshkruajnë kontratën në zyrën e noterisë ku jepen detajet e ndarjes së pronës.</li> <li>✓ Brenda 60 ditëve nga realizimi i matjeve gjeodezike, secili trashëgimtar duhet të paraqesë kërkesën në ZKK për regjistrimin e pronës së ndarë.</li> <li>✓ Trashëgimtari duhet të bashkëngjisë kontratën e noterizuar dhe të paguajë tarifën prej 20 €.</li> </ul>



## SI TA REGJISTRONI TË DREJTËN PRONËSORE ME VENDIM TË GJYKATËS?

Kur gjykata vendos për një kontest mbi të drejtat pronësore, ajo merr një vendim që konfirmon të drejtat e pronësisë mbi atë pronë të paluajtshme. Nëse jeni ju personi të drejtat pronësore të të cilit janë vendosur me vendim gjykatë, aplikohet procesi i mëposhtëm.



## SI TË REGJISTROHET PRONA E FITUAR PËRMES DHURIMIT?

Një person mund të bëhet pronar i një prone edhe duke e marrë atë si një dhuratë. Për të filluar procesin e regjistrimit të pasurisë së fituar si dhuratë në Zyrën Kadastrale Komunale, nevojitet kontratë ndërmjet dhuruesit dhe marrësit, e lidhur zyrtarisht nga noteri në prani të dhuruesit dhe marrësit në zyrën e noterit. Noteri përpilon aktin noterial që përmban informacion specifik në lidhje me pronën në fjalë. Noteri informon dhuruesin dhe marrësin për detyrimet që marrin përsipër me ekzekutimin e kontratës. Kontrata përcakton që marrësi dakordohet që ta pranojë dhuratën.

Tarifa noteriale për një dhuratë nga prindi për fëmijën është 50% e tarifës që zbatohet në rast të shitjes së pasurisë, tarifë që bazohet në vlerën e pasurisë. Nëse prona që dhurohet do të ndahet nga një pronë më e madhe, dhuruesi duhet të angazhojë gjeodet të licencuar ose kompani gjodezike për të kryer ndarjen e pronës.

Pronari i një pasurie të paluajtshme (dhuruesi) mund t'ia transferojë marrësit falas të drejtën mbi pasurinë e tij/saj ose një pjesë të pasurisë së tij/saj. Marrësi mund të jetë trashëgimtari i tij i mundshëm ligjor ose një palë e tretë/e jashtme. Marrësi(t) duhet të pajtohet ose të mos pajtohet për një dhurim të tillë. Prona që i nënshtrohet këtij transferimi nuk mund të jetë pjesë e një procesi pasues të trashëgimisë pas vdekjes së pronarit (përveç nëse ky transferim pengon realizimin e së drejtës trashëgimore të një ose më shumë trashëgimtarëve ligjorë). Marrëdhënia ndërmjet dhuruesit dhe marrësit përcaktohet në Ligjin mbi Detyrimet dhe pjesërisht në Ligjin mbi Trashëgiminë.

Dokumentet që duhet t'i paraqiten ZKK-së në raste të këtilla përfshijnë: formularin e plotësuar të aplikimit për regjistrim (Shtojca 3); Kontratën e dhurimit, të hartuar dhe vërtetuar nga noteri; Kopjen e letërnjoftimit tuaj; Dëshminë për pagimin e taksës së pronës së paluajtshme (nga Zyra Komunale e Tatimit në Pronë); Dëshminë e pagesës së tarifës së regjistrimit (zbatohen tarifa të ndryshme, ZKK do të informojë për tarifën e saktë të zbatuar në secilin rast specifik).

Ashtu si në rastet e tjera, ZKK lëshon certifikatën e pronësisë brenda 15 ditëve.

## PËRFUNDIME

Kosova ka një politikë dhe kornizë ligjore të zhvilluar mirë për qasjen në të drejtat pronësore. Megjithatë, janë disa sfida të mbetura, të konfirmuara edhe në Strategjinë Kombëtare të Kosovës për të Drejtat Pronësore që i referohen zbatimit të pamjaftueshëm të këtyre ligjeve, veçanërisht për gratë, personat e zhvendosur dhe komunitetet jo shumicë. Nën këtë premisë është hartuar edhe udhëzuesi aktual, për të kontribuar në zbatimin më të mirë të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese.

Vetëdija për të drejtat pronësore të dikujt, që përfshin, ndër të tjera, njohjen e kërkesave administrative, proceseve ligjore dhe aktorëve kryesorë, ndryshon sipas gjinisë, moshës, komunitetit dhe vendbanimit (urbane kundrejt ruraleve). Ndërsa dokumentet kryesore legjislative janë të disponueshme gjerësisht, komunitetet joshqiptare, në fakt, janë të privuara nga qasja në informacione praktike se si ta regjistrojnë një pronë; asnjë nga broshurat informative për regjistrimin e pronës dhe as modeli i formularit të regjistrimit të pronës (i disponueshëm në faqen e internetit të Agjencisë Kadastrale) nuk janë në dispozicion në gjuhët e folura nga shumica e komuniteteve jo shumicë. Për më tepër, fushatat e kontaktimit dhe ndërgjegjësimin në zonat rurale janë të një rëndësie vendimtare.

Rrjedhimisht, institucionet përkatëse dhe shoqëria civile duhet t'i rrisin përpjekjet e tyre në ngritjen e vetëdijes për qasjen dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore të grave, personave të zhvendosur dhe komuniteteve jo shumicë, në mënyrë që ato të mund t'i ushtrojnë plotësisht në praktikë të drejtat e tyre mbi pronën. Kjo përfshin dhënien e një këshille të informuar për të gjithë individët që duan dhe/ose kanë nevojë të informohen për të drejtat e tyre pronësore. Asnjëra nga këto nisma nuk duhet të pengohet nga normat tradicionale shoqërore dhe as nga një qasje e kufizuar në informacion.

## SHTOJCA 1: FORMULARI I REGJISTRIMIT TË PRONËS

### KËRKESA PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE PRONËSORE

Komuna \_\_\_\_\_

Zona kadastrale \_\_\_\_\_

Njësitë kadastrale \_\_\_\_\_

#### 1. Informacioni i aplikuesit

Emri / Emri i Kompanisë:	Mbiemri:	Emri i prindit:
Numri personal: Numri i biznesit: (për personat juridikë dhe kompanitë)	Adresa: Numri i telefonit:	

2. Aplikuesi:  Pronar  Përdorues  Përfaqësues i autorizuar

#### 3. Lista e dokumenteve të nevojshme:

Pronari/Përdoruesi	Përfaqësuesi i autorizuar
1 <input type="checkbox"/> Letërnjoftimi / Certifikatë e biznesit	1 <input type="checkbox"/> Letërnjoftimi / Certifikatë e biznesit
2 <input type="checkbox"/> Kontrata (origjinali ose kopja e vërtetuar nga autoriteti kompetent)	2 <input type="checkbox"/> Kontrata (origjinali ose kopja e vërtetuar nga autoriteti kompetent)
3 <input type="checkbox"/> Matja gjeodezike (në rast të njësive kadastrale të krijuara rishtas)	3 <input type="checkbox"/> Matja gjeodezike (në rast të njësive kadastrale të krijuara rishtas)
4 <input type="checkbox"/> Certifikata e pronësisë	4 <input type="checkbox"/> Autorizimi (nëse pala përfaqësohet nga dikush tjetër)
5 <input type="checkbox"/> Taksa e regjistrimit	5 <input type="checkbox"/> Certifikata e pronësisë
6 <input type="checkbox"/>	6 <input type="checkbox"/> Taksa e regjistrimit

## SHTOJCA 2: REGJISTRI KOMUNAL

### QENDRA RAJONALE PRIZREN

#### KOMUNA E DRAGASHIT

INSTITUCIONET PUBLIKE	ADRESA	EMAIL	TELEFONI
<b>Komuna e Dragashit</b>	Rr. Sheshi i Dëshmorëve	Nuk është në dispozicion	+383(0)29281543
<b>Zyrtar Komunal për Barazi Gjinore dhe Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut</b>	Ndërtesa e Komunës Rr. Sheshi i Dëshmorëve	<a href="mailto:lindita.piraj@rks-gov.net">lindita.piraj@rks-gov.net</a> Zyrtar Komunal për Barazi Gjinore <a href="mailto:mehmed.hamza@rks-gov.net">mehmed.hamza@rks-gov.net</a> Zyrtar Komunal për të drejtat e njeriut	044 389 757 044 354 629
<b>Stacioni i Policisë së Kosovës</b>	Brod Rr. pn, Dragash	<a href="mailto:info@kosovopoliice.com">info@kosovopoliice.com</a>	92 (tokësor) 192 (mobil)
<b>Institucioni i Avokatit të Popullit</b>	Mbuluar nga Zyra në Prizren	Nuk është në dispozicion (vetëm për zyrën kryesore në PR) <a href="mailto:info@ombudspersonkosovo.org">info@ombudspersonkosovo.org</a>	+383 (0)29 222 138
<b>Gjykata themelore</b>	Gjykata Themelore në Prizren  Dega në Dragash Sheshi i Dëshmorëve, pn	Afërdita Kicaj ----- Zyrtare për Media dhe Informim Publik (ZMIP); <a href="mailto:Aferdita.Kicaj@gjyqesori-rks.org">Aferdita.Kicaj@gjyqesori-rks.org</a>  Sabaheta Kurteshi - Këshilltar Mbikëqyrëse; <a href="mailto:Sebahate.Kurteshi@rks-gov.net">Sebahate.Kurteshi@rks-gov.net</a>	029 222 125; 045 418 394 (Tryeza e informacionit) 045 418 632 (ZMIP)
